

**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT- OST SH.A.  
DEPARTAMENTI I FINANCËS  
DREJTORIA EKONOMIKE**

Nr. 5686.....Prot

Tiranë, më 24/9 /2020

Lënda: Kërkesë për aplikim për Tarifën e Transmetimit të Energjisë Elektrike për vitin 2021.

**ENTIT RREGULLATOR TË ENERJISË** ✓  
Adresa: Blvd. Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023

**I nderuar Z. Ahmeti,**

Në përputhje me (i) Ligjin nr. 43/2015 dt. 30.4.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektike“, (ii) Metodologjinë e Llogaritjes së tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike, OST ka përgatitur “Përlllogaritjen e Tarifës për vitin kalendarik 2021“.

OST sh.a në llogaritjen e tarifës së transmetimit per vitin 2021 ka ndjekur me rigorozitet të drejtat dhe detyrat që ajo ka në referencë te ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektike“ nenet 55, 56, 60, 61, 62, 65 dhe 66, si dhe neni 2 i “Metodologjia e Llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

Ne reference të ligjit të sipërcituar neni 55, pika 1, jeni të lutur që të merrni në shqyrtim dhe të konsideroni materialin tonë për aplikimin e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për OST për vitin 2021.

Në mbështetje të kësaj kërkesë, bashkëlidhur do të gjeni:

- Relacioni sqarues për llogaritjen e tarifës

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, jemi në dispozicionin Tuaj për çdo sqarim dhe informacion të nevojshëm.

Me respekt,

**ADMINISTRATORI I OST sh.a.**

*Skerdi Drenova*  
**Skerdi Drenova**



## RELACION

### PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2021

#### Përmbajtja

<b>I.</b>	<b>Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.</b> .....	3
<b>II.</b>	<b>Niveli i synuar i të ardhurave që kërkohen prej tarifës së transmetimit.</b> .....	3
<b>III.</b>	<b>Pritshmëria e situatës energjitike për vitin 2020</b> .....	4
<b>IV.</b>	<b>Parashikimi i kërkesës për vitin 2021 dhe mënyra e mbulimit të saj</b> .....	6
<b>V.</b>	<b>Operatori i Tregut</b> .....	9
<b>VI.</b>	<b>Llogaritja e tarifave të transmetimit për vitin 2021</b> .....	10
A.	Kostot kapitale.....	10
<b>VII.1.</b>	<b>Investimet me fondet e huazuara që janë në proces implementimi</b> .....	12
<b>VII.2</b>	<b>Investimet me fondet e OST</b> .....	16
B.	Kostot operuese .....	25
C.	Të ardhurat nga Alokimi i Kapaciteteve .....	29
<b>VII.</b>	<b>Ndarja e kostove në kapacitet dhe energji</b> .....	30
i.	Pagesat e kapacitetit.....	30
ii.	Pagesat e energjisë .....	34
iii.	Llogaritja e tarifës mesatare të transmetimit.....	34

## **I. Informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a.**

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri administrohet, zhvillohet dhe sigurohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh. a.) për të garantuar që energjia elektrike transmetohet në sigurinë dhe cilësinë e kërkuar për të përmbushur nevojat e prodhuesve dhe përdoruesve të saj. OST sh.a është një kompani publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit e krijuar në 14/07/2004.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi OST sh. a. ka përgjegjësinë të operojë, të mirëmbajë dhe të zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a) është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri i cili ka përgjegjësinë ligjore për infrastrukturën kritike të rrjetit të transmetimit dhe dispeçerimit të saj. Bazuar në këtë rol të rëndësishëm, kompania e mbështet zhvillimin e vet në planet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike në vend.

Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Operatori i Sistemit të Transmetimit ka në pronësi sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, që përfshin linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, nënstationet e transformimit të energjisë elektrike me nivele të transformimit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe zbarat 110 kV në të gjitha nënstationet 110/TM kV, deri në pikën e matjes së energjisë në anën 110 kV të transformatorëve 110/TM kV, përfshirë pajisjet kyçëse/shkyçëse të linjave 110 kV.

Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet garantojë kushtet për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit, lidhjet e reja në rrjet dhe siguron aftësinë afatgjatë të sistemit për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike, duke operuar, ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase sistemin e transmetimit, në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit..

## **II. Niveli i synuar i të ardhurave që kërkohen prej tarifës së transmetimit.**

Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike synon të mbledhë të ardhurat e nevojshme për të zhvilluar investimet e nevojshme në sistem, për të mbuluar kostot operative të drejtimin të shoqërisë si dhe për të minimizuar humbjet në rrjetin e transmetimit.


Tarifa e transmetimit synon të shlyejë kostot e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Pronësinë, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave, kablllove, nënstationeve, transformatoreve, qëndrave dispeçer dhe ndërtesave që lidhen me to si dhe facilitetet e komunikimit.
- b) Kostot e rezervave operuese të OST-së që nevojiten për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit të transmetimit.

- c) Kostot e shërbimeve të tjera ndihmëse të OST-së, përfshirë pagesat e bëra OST-ve fqinje për të siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva të çastit dhe pagesat (nëse ka) për frekuencën dhe rregullimin e tensionit.
- d) Kostot e kompensimit të energjisë reaktive, që duhen alokuar në një pagesë për energjinë reaktive.
- e) Kostot për të siguruar zyra, komunikim dhe facilitete të Teknologjisë së Informacionit (IT) për Operatorin e Tregut plus kostot e personelit që lidhen me Operatorin e Tregut. Nga këndvështrimi kontabël Operatori i Tregut duhet të këtë llogaritë e tij, sikur të ishte një njësi ligjore e pavarur me të ardhura të tatueshme më vete.
- f) Pagesat e detyrimeve që vijnë nga të gjitha huatë e marra për zhvillimin e rrjetit të transmetimit.
- g) do të mbulojë kostot e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit si dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse e të balancimit të prokuruar në treg.

### III. Pritshmëria e situatës energjitike për vitin 2020

Pershkrimi (GWh)	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Realizimi i pritshëm për vitin 2020
<b>ENERGJIA TOTALE QË HYJNE NË SISTEMIN E OST</b>	6,997	8,472	7,430	7,679	9,035	7,699	7,830	8,250	7,577	9,648	7,943	8,156
- Prodhimi vendas	5,032	7,467	3,956	4,449	6,712	4,343	5,475	6,000	4,174	8,077	4,767	4,847
- Energji në marrje	1,964	1,005	3,474	3,230	2,323	3,356	2,355	2,250	3,403	1,772	3,177	3,309
<b>ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR</b>	6,785	8,214	7,256	7,509	8,825	7,538	7,672	8,080	7,418	9,606	7,775	7,984
- Energji e dhene	536	1,736	293	336	1,425	288	958	1,500	488	2,685	770	890
- Energji e transmetuar për OSHEE	6,213	6,284	6,832	6,576	6,797	6,553	6,106	5,980	6,149	5,963	6,137	6,166
- Energji e transmetuar për Klientet e Kualifikuar	36	194	131	597	603	697	610	600	781	957	867	928
Humbjet në rrjetin e Transmetimit + Nevojat Vetëake	211	258	174	170	210	161	158	170	159	243	169	172
Humbjet në rrjetin e Transmetimit në %	3.02	3.05	2.34	2.21	2.32	2.09	2.02	2.06	2.10	2.46	2.12	2.11



### Realizimi i parametrave kryesorë energjetikë gjatë vitit 2020

Viti 2020 filloi me një kuotë rreth 276 metra në liqenin e Fierzës, një kuotë e jo fort e favorshme për ruajtjen e një niveli normal të sigurisë së furnizimit. Prurjet mesatare mujore të lumit Drin në liqenin e Fierzës, me përjashtim të muajit mars, rezultuan të peraferta ose me të vogla se prurjet llogaritese, të parashikuara me nivel sigurie 75%. Si rrjedhojë e kësaj shtate, dhe me qellim rritjen e rezervës energjetike në kaskaden e Drinit, është rritur sasia e importit të energjisë elektrike nga ana e OSHEE por edhe e konsumatoreve të kualifikuar. Kapaciteti transmetues nderkufitar ka qenë mëse i mjaftueshëm për realizimin e ketyre sasive të importit, si edhe për realizimin e tranziteve sipas kapaciteteve transmetuese perkatëse të alokuara nga zyra rajonale CAO.

Bazuar në të dhënat e deritanishme dhe në parashikimin për muajt e ardhshëm, pritet që gjenerimi i vendit që injektohet në rrjetin e transmetimit të jetë rreth 4.8 TWh, importi total rreth 2.5 TWh, konsumi (terheqja nga rrjeti i transmetimit) rreth 7.3 TWh përfshirë humbjet në rrjetin e transmetimit me rreth 172 GWh.


Në tabelën e mëposhtme jepen treguesit kryesorë të Prodhimit, Shkëmbimit dhe Konsumit për vitin 2020 (periudha janar – gusht me vlerat e realizuara, pjesa tjetër me vlerat e pritëshme).

Prurja në Fierze, me 75% siguri	m3/s	148	169	177	232	195	112	58	41	50	63	110	169	127
Prurja në Fierze, faktike	m3/s	102	112	256	171	160	113	57	60	50	65	115	170	119
Kuota në Fierze në fillim të muajit	m	275.9	271.7	272.1	283.6	288.8	293.7	291.6	284.6	276.5	271.2	271.2	276.3	
Kuota në Fierze në fund të muajit	m	271.7	272.1	283.6	288.8	293.7	291.6	284.6	276.5	271.2	271.2	276.3	282.1	280
Diferenca mesatare ditore	cm	-13.7	1.5	36.9	17.6	15.7	-6.8	-22.7	-26.1	-17.9	0.1	17.0	18.9	1.7
Prodhimi në Fierze	GWh	109.8	63.4	32.9	39.9	27.4	120.9	162.0	147.4	94.9	43.1	17.3	41.6	901
Prodhimi në Koman	GWh	142.0	111.4	102.1	67.7	80.8	111.4	152.1	152.1	102.3	71.0	85.3	134.8	1,313
Prodhimi në V.Dejes	GWh	69.7	58.3	54.8	30.9	41.8	51.9	71.5	70.6	51.4	37.7	50.7	76.7	666
Prodhimi në Ashta	GWh	18.6	16.1	15.4	8.6	11.4	13.6	17.5	17.5	9.2	6.8	9.1	13.8	158
Prodhimi i Kaskades	GWh	340.1	249.2	205.1	147.1	161.3	297.8	403.1	387.6	257.8	158.6	162.4	266.9	3,037
Prodhimi në HEC e Tjere	GWh	153.6	170.0	277.8	203.1	163.1	85.6	63.7	55.4	86.4	148.8	180.0	223.2	1,811
Prodhimi në TEC	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0
Prodhimi i vendit	GWh	493.7	419.2	482.9	350.2	324.4	383.4	466.8	443.0	344.2	307.4	342.4	490.1	4,848
Konsumi i mujor	GWh	730.8	634.3	601.3	493.1	502.6	519.3	593.5	607.5	560.2	605.0	630.4	787.7	7,266
Konsumi mesatar ditor	GWh	23.6	21.9	19.4	16.4	16.2	17.3	19.1	19.6	18.7	19.5	21.0	25.4	19.8
Importi mujor	GWh	237	215	118	143	178	136	127	165	216	298	288	298	2,418
Importi mesatar ditor	GWh	7.6	7.4	3.8	4.8	5.7	4.5	4.1	5.3	7.2	9.6	9.6	9.6	6.6
Diferenca nga planifikimi mujor	GWh	-22.5	13.7	-18.7	-67.9	-52.3	-48.6	-19.8	-38.5	0.0	0.0	0.0	0.0	-21.2
Diferenca nga planifikimi ditor	GWh	-0.7	0.5	-0.6	-2.3	-1.7	-1.6	-0.6	-1.2	0.0	0.0	0.0	0.0	-0.7
Konsumi i planifikuar, mujor	GWh	753	621	620	561	555	568	613	646	560	605	630	788	7,520
Konsumi i planifikuar, ditor	GWh	24.3	21.4	20.0	18.7	17.9	18.9	19.8	20.8	18.7	19.5	21.0	25.4	20.5

#### IV. Parashikimi i kërkesës për vitin 2021 dhe mënyra e mbulimit të saj

Mbi bazën e të dhënave historike për dhjetë vitet e fundit, rezulton se gradienti mesatar i rritjes së kërkesës për energji elektrike, që transmetohet nëpërmjet rrjetit për OSSH dhe konsumatorët e lidhur në rrjetin e transmetimit është praktikisht zero, edhe duke mos konsideruar vitin 2020, ku një nga pasojat e pandemisë COVID 19 është ulja e konsumit të energjisë elektrike, sic paraqitet në tabelën e mëposhtme:

23,779	22,978	21,055	18,313	17,452	17,112	18,159	19,056	17,784	18,408	21,356	23,440	
24,358	23,940	19,626	19,506	17,487	18,138	19,581	19,895	18,449	17,861	20,088	25,252	
25,170	24,999	22,871	19,289	17,938	18,928	19,673	19,731	18,267	18,790	21,346	26,372	
24,686	23,420	21,833	20,182	18,152	18,023	18,657	19,991	18,502	19,512	20,195	22,104	
22,173	20,912	19,248	16,710	16,558	16,893	18,766	19,010	17,174	15,677	17,955	21,512	
21,616	18,688	18,121	15,897	16,016	15,722	17,443	17,847	16,270	16,458	18,600	23,104	
24,259	20,737	18,514	17,819	16,817	18,341	19,251	19,889	17,269	17,901	20,088	22,340	
21,841	22,339	20,833	17,696	17,175	17,678	18,655	20,039	17,972	17,896	19,710	23,912	
24,237	21,447	19,915	18,634	17,790	18,826	19,752	20,954	18,076	16,781	17,933	21,668	
23,573	21,873	19,411	16,436	16,212	17,310	19,146	19,597					Mesatare
2.4%	4.2%	-6.8%	6.5%	0.2%	6.0%	7.8%	4.4%	3.7%	-3.0%	-5.9%	7.7%	2.3%
3.3%	4.4%	16.5%	-1.1%	2.6%	4.4%	0.5%	-0.8%	-1.0%	5.2%	6.3%	4.4%	3.7%
-1.9%	-6.3%	-4.5%	4.6%	1.2%	-4.8%	-5.2%	1.3%	1.3%	3.8%	-5.4%	-16.2%	-2.7%
-10.2%	-10.7%	-11.8%	-17.2%	-8.8%	-6.3%	0.6%	-4.9%	-7.2%	-19.7%	-11.1%	-2.7%	-9.2%
-2.5%	-10.6%	-5.9%	-4.9%	-3.3%	-6.9%	-7.1%	-6.1%	-5.3%	5.0%	3.6%	7.4%	-3.0%
12.2%	11.0%	2.2%	12.1%	5.0%	16.7%	10.4%	11.4%	6.1%	8.8%	8.0%	-3.3%	8.4%
-10.0%	7.7%	12.5%	-0.7%	2.1%	-3.6%	-3.1%	0.8%	4.1%	0.0%	-1.9%	7.0%	1.2%
11.0%	-4.0%	-4.4%	5.3%	3.6%	6.5%	5.9%	4.6%	0.6%	-6.2%	-9.0%	-9.4%	0.4%
-2.7%	2.0%	-2.5%	-11.8%	-8.9%	-8.1%	-3.1%	-6.5%					-5.2%
0.5%	-0.5%	-0.3%	0.6%	0.3%	1.5%	1.2%	1.3%	0.3%	-0.8%	-1.9%	-0.6%	0.1%



Gjithsesi edhe në versionin pesimist të evoluimit të kërkesës për energji elektrike duhet të konsiderohet një rritje e kërkesës prej rreth 1%, duke konsideruar gjithashtu se pasojat e pandimesë që lidhen me konsumin e energjisë elektrike nuk do të jenë prezente në vitin 2021. Pra duke pranuar që rritja e pritshme e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST per konsum, të jetë e rendit 1%, dhe duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të cdo muaji, është bërë parashikimi i volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nëpërmjet rrjetit të transmetimit për vitin 2021, si në tabelën e mëposhtme:

Mujore	GWh	753	599	620	515	532	548	613	646	561	601	623	788	Total
Mesatare	MWh	24,300	21,400	20,000	17,165	17,175	18,270	19,785	20,840	18,705	19,385	20,775	25,410	7,400
Orar / Ditët→		31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	
1	MW	675	600	595	500	525	600	630	660	590	540	575	720	
2	MW	585	530	540	450	485	530	580	625	535	480	545	635	
3	MW	540	495	515	425	470	500	555	590	515	465	520	590	
4	MW	525	485	505	420	470	490	540	580	510	455	510	585	
5	MW	535	500	520	425	480	500	545	580	510	480	530	595	
6	MW	590	555	580	455	500	520	580	600	545	550	610	670	
7	MW	755	735	745	560	590	630	675	700	665	715	775	860	
8	MW	1,010	980	925	700	710	750	810	830	775	885	950	1,110	
9	MW	1,155	1,080	990	810	810	850	900	920	860	935	1,000	1,230	
10	MW	1,205	1,085	975	860	860	870	945	960	900	925	975	1,230	
11	MW	1,195	1,045	945	890	880	880	955	990	910	890	950	1,210	
12	MW	1,185	1,015	920	900	885	890	970	1015	925	880	930	1,170	
13	MW	1,180	1,000	905	895	880	895	975	1025	920	875	920	1,160	
14	MW	1,190	1,005	910	880	870	900	975	1030	920	880	930	1,170	
15	MW	1,190	1,000	905	825	800	890	955	1005	880	885	935	1,180	
16	MW	1,195	995	900	780	780	850	930	985	860	900	955	1,210	
17	MW	1,240	1,005	900	750	750	850	920	975	835	970	1,035	1,290	
18	MW	1,335	1,105	945	770	770	855	920	980	845	1,100	1,175	1,390	
19	MW	1,345	1,190	1,070	800	790	860	930	1000	865	1,130	1,185	1,420	
20	MW	1,340	1,185	1,095	900	810	870	940	1020	970	1,075	1,155	1,405	
21	MW	1,300	1,155	1,065	970	890	910	980	1080	995	1,030	1,085	1,350	
22	MW	1,190	1,050	975	850	840	900	975	1010	895	910	975	1,240	
23	MW	1,020	895	840	730	720	780	870	900	805	790	855	1,100	
24	MW	820	710	735	620	610	700	730	780	675	640	700	890	
Σ	MWh	24,300	21,400	20,000	17,165	17,175	18,270	19,785	20,840	18,705	19,385	20,775	25,410	

Në total, pritet që konsumi bruto për vitin 2021 të jetë i rreth 7.4 TWh.

Mënyra e mbulimit të kërkesës së pritshme është bërë në bazë të eksperiencës tashmë shumë vjecare, duke konsideruar prurjet në kaskadë me 75% siguri, nivelin e liqenit në Fierzë (të pritshëm) në fillim të vitit, rritjen potenciale të numrit dhe volumit të gjenerimit të PVE-ve dhe PPE-ve, eksportin e mundshëm nga ana e tyre në varësi të kushteve të tregut të brendshëm të energjisë dhe importit të energjisë që bëhet nga ana e FTL(OSHEE) dhe konsumatorëve të kualifikuar, duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit të tyre dhe kërkesën për energji, dhe duke treguar kujdes gjithashtu për optimizimin e kaskadës së Drinit, ruajtjen e kuotës në Fierzë, pra eficientë e gjenerimit, si dhe fillimin e vitit tjetër me një kuotë dhe rezervë energjetike optimale për të perballuar kërkesën për energji elektrike normalisht në rritje. Parashikimi i parametrave kryesore dhe llogaritjet përkatëse janë të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

Prurja ne Fierze, me 75% siguri	m3/s	148	169	177	232	195	112	58	41	50	63	110	169	127
Prurja ne Fierze, faktike	m3/s	150	170	180	235	200	115	60	45	50	65	115	170	130
Kuota ne Fierze ne fillim te muajit	m	282.0	279.5	279.8	283.6	291.5	295.3	293.2	289.4	283.1	276.8	275.2	279.6	
Kuota ne Fierze ne fund te muajit	m	279.5	279.8	283.6	291.5	295.3	293.2	289.4	283.1	276.8	275.2	279.6	283.9	284
Diferenca mesatare ditore	cm	-8.1	1.1	12.3	26.4	12.1	-6.9	-12.3	-20.4	-20.9	-5.0	14.5	13.8	0.5
Prodhimi ne Fierze	GWh	148.0	105.5	79.5	35.5	76.9	125.9	117.4	138.6	121.7	64.2	22.5	65.0	1,101
Prodhimi ne Koman	GWh	172.9	124.7	123.5	130.7	149.9	151.6	120.1	132.1	122.5	121.1	108.3	153.0	1,610
Prodhimi ne V.Dejes	GWh	92.1	67.8	69.6	82.0	79.3	76.9	60.0	65.9	61.2	68.4	63.4	91.9	879
Prodhimi ne Ashta	GWh	16.6	12.2	12.5	14.8	14.3	13.8	10.8	11.9	11.0	12.3	11.4	16.5	158
Prodhimi i Kaskades	GWh	429.7	310.2	285.2	262.9	320.4	368.1	308.3	348.4	316.4	266.1	205.6	326.4	3,748
Prodhimi ne HEC e Tjere	GWh	174.8	188.2	297.6	216.0	174.8	108.0	81.8	74.4	100.8	148.8	201.6	238.1	2,005
Prodhimi ne TEC	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0
Prodhimi i vendit	GWh	604.5	498.4	582.8	478.9	495.2	476.1	390.1	422.8	417.2	414.9	407.2	564.5	5,753
Konsumi i mujor	GWh	753.3	599.2	620.0	514.9	532.4	548.1	613.3	646.0	561.2	600.9	623.2	787.7	7,400
Konsumi mesatar ditor	GWh	24.3	21.4	20.0	17.2	17.2	18.3	19.8	20.8	18.7	19.4	20.8	25.4	20
Importi mujor	GWh	149	101	37	36	37	72	223	223	144	186	216	223	1,648
Importi mesatar ditor	GWh	4.8	3.6	1.2	1.2	1.2	2.4	7.2	7.2	4.8	6.0	7.2	7.2	4.5
Diferenca nga planifikimi mujor	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Diferenca nga planifikimi ditor	GWh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Konsumi i planifikuar, mujor	GWh	753	599	620	515	532	548	613	646	561	601	623	788	7,400
Konsumi i planifikuar, ditor	GWh	24.3	21.4	20.0	17.2	17.2	18.3	19.8	20.8	18.7	19.4	20.8	25.4	20.3

Nga llogaritjet, me probabilitetin e pranuar të prurjeve në kaskadën e Drinit, (prurja mesatare vjetore në Fierzë 130 m<sup>3</sup>/s, në Koman 70 m<sup>3</sup>/s, në V.Dejes 20 m<sup>3</sup>/s), rezulton se prodhimi i pritshëm i kaskadës (pjesa e KESH) është i rendit 3.6 TWh, prodhimi i centraleve me koncesion dhe atyre private pritët të jetë rreth 2.1 TWh. Pjesa tjetër e energjisë e nevojshme për të mbuluar kërkesën për energji elektrike duhet të importohet, dhe pritët që fizikisht importi nga interkoneksioni të jete i rendit 1.7 TWh.

Importi i energjisë nga OSHEE për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe nga Furnizuesit e Kualifikuar për konsumatorët respektivë, është kalkuluar në mënyrë komplementare me probabilitetin e përzgjedhur të prodhimit nga hidrocentralet e vendit. Ndryshimi i sasisë vjetore të importit që mund të diktohet nga ndryshimi i prodhimit të vendit si rrjedhojë e ndryshimeve të situatës hidrike, sic e ka treguar eksperienca e deritanishme, nuk e ndryshon planifikimin e kërkesës për energji elektrike.

Bazuar në të dhënat historike, dhe duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit dhe volumit të kërkesës së Konsumatorëve të Kualifikuar, prodhimin e PVE dhe PPE, si dhe sasinë e energjisë që nevojitet për të mbuluar humbjet në rrjetin e transmetimit, është plotësuar tabela e bilancit të energjisë për vitin 2021 si më poshtë:

I.	Energjia Totale që hyn ne sistemin e OST	GWh	943	798	813	699	755	726	710	783	692	725	757	944	9,345
a)	Prodhim vendas	"	605	498	583	479	495	476	390	423	417	415	407	564	5,752
b)	Energji ne marrje	"	338	300	230	220	260	250	320	360	275	310	350	380	3,593
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	924	781	796	685	741	712	696	769	679	711	741	926	9,161
a)	Energji elektrike e dhene	"	190	198	193	184	223	178	97	137	131	124	134	156	1,945
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	674	528	543	446	458	466	524	557	460	482	492	650	6,280
c)	Energji elektrike per konsumatorët e kualifikuar	"	60	55	60	55	60	68	75	75	88	105	115	120	936
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	19	17	17	14	14	14	14	14	13	14	16	18	184
b)	Humbjet ne %	%	2.01%	2.13%	2.09%	2.00%	1.85%	1.93%	1.97%	1.79%	1.88%	1.93%	2.11%	1.91%	1.97%



## V. Operatori i Tregut

Operatori i Tregut (OT), është pjese e strukturës së OST në nivel Drejtorie dhe perbehet nga 3 sektore.

OT administron “Regjistrin e Palëve të Tregut” te energjise elektrike si edhe ndjek procedurat e regjistrimit të paleve ne treg, mbështetur në Rregullat e Tregut ( RrT ) dhe vendimet perkatese te ERE-s

Aktualisht (Shtator 2020)

Janë të regjistruar në Tregun e Energjisë Elektrike rreth 57 subjekte nga te cilet:

- 33 kane statusin aktiv, 4 jane te pezulluar dhe 20 kane perfunduar Marveshjen per pjesmarrje ne treg
  - 49 subjekte në rolin e Tregtuesit, 27 kane statusin aktiv, 3 jane te pezulluar dhe 19 kane perfunduar Marveshjen per pjesmarrje ne treg
  - 36 subjekte në rolin e Furnizuesit, 20 kane statusin aktiv, 2 jane te pezulluar dhe 14 kane perfunduar Marveshjen per pjesmarrje ne treg
  - 13 subjekte në rolin e prodhuesit, 8 jane aktiv, 1 eshte i pezulluar dhe 4 kane perfunduar Marveshjen per pjesmarrje ne treg
  - 15 subjekte, me pike lidhje ne rrjetin e ST blejne energjine elektrike ne treg te lire
  - 53 subjekte, me pike lidhje ne rrjetin e SSH, ne tension 35 KV, blejne energjine elektrike ne treg te lire
  - OSHEE eshte kompania meme e tre kompanive, Operatorit te Sistemit te Shpërndarjes (OSSH), Furnizuesit Sherbimit Universal (FSHU) dhe Furnizuesit te Tregut te Lire (FTL)
  - KESH vijon në rolin e Prodhuesit dhe në rolin e Tregtuesit.

Janë paraqitur nga palët e tregut dhe janë administruar në regjistrin e OT gjithsej:

- 442 kontrata të transaksioneve të energjisë elektrike (4'816'381 MWh)
  - 15 kontrata (332'035 MWh) janë kontrata eksporti të energjisë elektrike;
  - 114 kontrata (1'021'979 MWh) janë kontrata importi të energjisë elektrike;
  - 160 kontrata (2'750'626 MWh) janë kontrata shkëmbimi ndërmjet Palëve të Tregut;
  - 74 kontrata (639'586 MWh) janë ndermjet Furnizuesve dhe Konsumatoreve ne treg te lire, me pike lidhje ne rrjetin e sistemit transmetimit (15 konsumatore)
  - 79 kontrata (72'755 MWh) janë ndermjet Furnizuesve dhe Konsumatoreve ne treg te lire, me pike lidhje ne rrjetin e sistemit shperndarjes (53 konsumatore)

Gjithashtu me implementimin e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, ndryshuar me ligjin nr. 7/2018, datë 15.02.2018, si dhe VKM nr 322 date 15.05.2019 dhe VKM nr 609 date 12.09.2019, do të mundësohet krijimi i tregut te dites ne avance dhe atij brenda dites si edhe shtimi i prodhuesve dhe konsumatoreve të cilët shkëmbejne energjinë elektrike në tregun e lirë sipas cmimeve te dites ne avance, te cilat jane transparente.

## VI. Llogaritja e tarifave të transmetimit për vitin 2021

Sipas metodologjisë llogaritja për të ardhurat e kërkuara bëhet në bazë vjetore. OST ka llogaritur kostot totale që ajo do të perballojë gjatë gjithë vitit 2021.

Niveli i synuar i të ardhurave që kërkohen nga OST do të mbulojë të gjitha kostot e lejuara nga Metodologjia e Transmetimit të Energjisë Elektrike respektivisht kostot e kapitalit dhe kostot operative.

**Niveli i synuar i të ardhurave që do të mblidhen gjatë vitit bazë është i barabartë me:**

$$C = C_{\text{kapitale}} + C_{\text{operuese}}$$

### A. Kostot kapitale

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit në perputhje me parashikimet afatgjata dhe me planet e zhvillimit të sektorit elektroenergjetik në tërësi është një nga funksionet themelore të OST dhe përbën një domosdoshmëri për kryerjen e funksioneve të saj.

Gjatë viteve të fundit janë kryer një sërë studimesh të sistemit të transmetimit që kanë përcaktuar projektet kryesore të nevojshme për zhvillimin e tij. Disa nga këto projekte janë në fazë implementimi dhe të tjerë, për të cilët është siguruar financimi nga institucione financiare ndërkombëtare do të vihen në zbatim në një periudhë kohore të përcaktuar.

Rrjeti i transmetimit ka një shtrirje të gjerë në të gjithë territorin e vendit. Në pjesën 110 kV janë lidhur nënstacionet transformuese 110/TM kV, të cilët furnizojnë me energji elektrike të gjitha zonat urbane të vendit. Gjithashtu në zbarat e nenstacioneve 110 kV pranë zonave me burime hidrike janë lidhur një numër i rëndësishëm i HEC-eve të rinj.

OST gjithmonë ka mundur të transmetojë gjenerimin e plotë të vendit pa asnjë kufizim dhe me nivel të lartë sigurie, por në vitet e fundit jemi gjendur përballë një rritje të gjenerimit të vendit të rendit rreth 30 % më të lartë nga ajo e maksimumit të arritur më parë. Kjo, për shkak se në rrjetin e sistemit elektroenergjetik (rrjetin e shpërndarjes dhe të transmetimit) janë futur një numër i madh gjeneruesish të rinj. Praktika e operimit në këtë situatë ekstreme nxori në pah disa nyje kritike të sistemit të transmetimit të cilat paraqiten më poshtë.

Gjithashtu, pjesa më e madhe e rrjetit 110 kV përfshirë linjat dhe nënstacionet e lidhur në të, kanë tashmë një periudhë shfrytëzimi rreth 50 vjeçare.

Mbi bazën e evidentimeve të sakta janë bërë ndërhyrje të thella në linjat kryesore të transmetimit që njëkohësisht kalojnë në terrene malore dhe me kushte mjaft të vështira të motit në periudhën e dimrit. Ndërhyrjet kanë konsistuar në përforcimet e konstruksioneve të shtyllave duke plotësuar elementet e hequr nga keqbërësit, ndërrimin e izolatorëve të dëmtuar, riparimin e defekteve në percjellës dhe në raste të caktuara zëvendësimin e tij.

Megjithë masat e mësipërme, në pjesën më të madhe të rrjetit 110 kV nuk janë bërë ndërhyrje rehabilituese të thella dhe shkalla e amortizimit të paisjeve të tyre është tepër e lartë. Nga evidentimi ka dal në pah se:

- Elementët konstruktivë të linjave janë tejet të amortizuara dhe me kapacitet të ulët.
- Ndërtimet informale poshtë linjave të vjetëruara e rrisin rrisin e demtimeve nga rryma elektrike.
- Mbingarkimi i linjave shumë pranë limiteve të qëndrueshmërisë termike.
- Në disa nënstationë paisjet primare (çelsa, thika) nuk komutohen dhe disa prej tyre janë të shuntuar.
- Sistemi i zbarave është me përcjellës me kapacitet të ulët dhe amortizimi i morsetave lidhëse është tepër i lartë.
- Konstruksionet metalike të paisjeve janë të koroduara, sistemi i tokëzimit gjithashtu.
- Sistemi i mbrojtjes rele është me paisje të vjetëruara që tashmë nuk përdoren më. Ai nuk është i sigurtë, nuk vepron në mënyrë selektive dhe në shumë raste nuk reagon fare.
- Sistemet e kontrollit lokal janë jashtë funksionit dhe manovrimet në disa raste bëhen vetëm në fushë, disa prej këtyre nënstationeve nuk përfshihen në sistemin SCADA të Qëndres Kombëtare Dispecer.

Si rezultat i kësaj gjendjeje kemi pasojat në:

- Mungesën e elementëve komutues, që redukton fleksibilitetin e operimit të skemës dhe shpesh bëhet shkak për ndërprerje të furnizimit të konsumatorëve për kryerjen e monovrimeve që janë të nevojshme për operimin në kohë reale.
- Rrezikun me të cilin ndeshet personeli operativ gjatë manovrimit të rrjetit.
- Vështirësi në identifikimin e difekteve në linjat 110 kV, kjo për shkak të mungesës së selektivitetit dhe identifikimit të zonës ku është dëmtuar linja.
- Ndërprerje të furnizimit me energji të konsumatorëve apo të gjenerimeve të HEC-eve lokale, për shkak të demtimeve të shpeshta në rrjet dhe në paisjet e nënstationeve.
- Rritje të numrit të stakimeve
- Kohë më e gjatë për kryerjen e remonteve.
- Operimin e rrjetit me humbje më të medha.
- Etj.

Nisur nga sa më sipër shohim të nevojshme kryerjen e ndërhyrjeve rehabilituese në disa prej linjave 110 kV të rrjetit të transmetimit duke marrë në konsideratë:

- a) Shkalla e amortizimit të linjave dhe impianteve të nënstationeve 110 kV.
- b) Rëndësia që kanë linjat dhe nënstationet 110 kV për operimin në kohë reale dhe rritjen e fleksibilitetit të rrjetit 110 kV.
- c) Mos plotësimi i kriterit të sigurisë statike N-1.
- d) Ecuria me të njëjtën linjë me zhvillimin e Sektorit të Energjisë Elektrike

Rankimi i projekteve sipas prioritetit që ato përfaqësojnë, duke filluar nga ato më emergjentet (afat-shkurtër), afat-mesëm dhe afat-gjatë.

## VII.1. Investimet me fondet e huazuara që janë në proces implementimi

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit në përputhje me parashikimet afatgjata dhe me planet e zhvillimit të sektorit elektroenergjetik në tërësi është një nga funksionet themelore të OSTsh.a. dhe përbën një domosdoshmëri për kryerjen e funksioneve të saj. Gjatë viteve të fundit janë kryer një sërë studimesh të sistemit të transmetimit që kanë përcaktuar projektet kryesore të nevojshme për zhvillimin e tij. Disa nga këto projekte janë në fazë implementimi dhe të tjerë, për të cilët është siguruar financimi nga institucione financiare ndërkombëtare do të vihen në operim në një periudhë kohore të përcaktuar.

### ✓ *Projekti “Programi i Efijencës së Energjisë të Sektorit të Transmetimit” -Loti 1- Nënstacionet dhe Lot 2- Linjat*

Projekti është financuar nga një kredi prej 40,000,000 Euro e akorduar nga Qeveria Gjermane, nëpërmjet Bankës KfW.

Ky projekt do të bëjë të mundur rritjen e besueshmërisë së funksionimit të rrjetit 220 kV të rajonit të Durrësit dhe të Jugut të Shqipërisë duke plotësuar kriteret teknike të sigurisë dhe cilësisë. Gjithashtu ky projekt do të përmirësoj kushtet aktuale të furnizimit me energji elektrike në qytetin e Tiranës, duke konsideruar që një pjesë e rëndësishme e rrjetit unazor 110 kV që furnizon me energji elektrike nënstationet e sistemit të shpërndarjes në zonën e Tiranës, i ndërtuar përpara mbi 40 vjetësh i përbërë nga linja ajrore të amortizuara dhe kapacitet transmetimi të limituar.

Shërbimi i konsulencës nga kompania Fichtner GmbH & Co KG, do të mbulojë dhe implementimin e projektit (dy Lotet).

Zbatimi i projektit, do të bëhet i mundur në 2 Lote:

#### ***Lot 1: Nënstacionet***


- Instalimi i dy transformatorëve 220/110/20 kV me fuqi 150 MVA në Nënstationin e Rrashbullit;
- Ndërtimi i një Nënstationi të ri Tirana (3) 400/110/20 kV si edhe përforcimi i Nënstacioneve Tirana 1 , Traktori dhe Selita.

Kontrata për zbatimin e projektit Lot 1- Nënstacionet është lidhur në datë 14.11.2018 me Kontraktorin EFACEC Engenharia e Sistemas, S.A. dhe është bërë efektive në datë 28.03.2019 me vlerë totale 19.277.703 Euro.


### Lot 2: Linjat

- Ndërtimi i një linje të re me dy qarqe 220 kV Tirana 2 – Rrashbull dhe dy dalje të reja përkatësisht në Nënstacionin Tirana 2 dhe Rrashbull;
- Ndërtimi i unazës 110 kV: Tirana 1 – Traktori linjë kabllore 110 kV;
- Tirana 3 – Traktori linjë 110 kV pjesërisht kabllore dhe pjesërisht ajrore;
- Tirana 3 – Selita linjë 110 kV pjesërisht kabllore dhe pjesërisht ajrore.

Kontrata për zbatimin e projektit Lot 2: Linjat është lidhur në datë 27.12.2018 me Kontraktorin Energoinvest d.d Sarajevo dhe është bërë efektive në datë 06.05.2019 me vlerë totale 18.405.408,36 Euro.



Linja 220 kV me dy qarqe Tirana 2- Rrashbull dhe fuqizimi i N/st. 220/110 kV Rrashbull



Skema njëfazore e realizimit të projektit të Unazës së Tiranës

Pas përfundimit të hartimit të projektit/design, marrjes së lejes së ndërtimit në institucionet e linjes si dhe kryerjes së procedurave të shpronësimit, parashikohet që në vitin 2021 kontratat e zbatimit (sipas Loteve) të nisnin procesin e implementimit (duke vijuar me lëvrim të mallrave dhe kryerjen e punimeve sipas Price Schedule, pjesë e kontratave), si dhe pagesat respektive për shërbimin e konsulencës e cila ka hyre në Fazën e implementimit.

Parashikohet që një vlerë prej 16,664,257 Euro do të disbursohen gjatë vitit 2021 për këtë projekt.

✓ ***Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan2 (Shqipëri) – Bitola (Maqedoni) dhe Elbasan2 – Fier si dhe si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan2 dhe Fier***


Financimi i këtij projekti, do të sigurohet nga Bashkëpunimi Gjermano-Shqiptar i Zhvillimit. Qeveria Gjermane, tashmë ka angazhuar fonde për një kredi të zhvillimit deri në 50.000.000 Euro për Qeverinë Shqiptare. Përveç kësaj, për të mbuluar financimin e plotë të projektit, do të vihesh në dispozicion një grant nga WBIF prej 13.720.000 Euro. Gjithashtu, rreth 1.131.000 Euro, do të angazhohen nga WBIF dhe Bashkëpunimi për Zhvillim Gjermano-Shqiptar, fonde të cilat do të përdoren për përgatitjen e dizajnit kryesor. OST sh.a. është angazhuar të mbulojë përgjatë implementimit të projektit dhe kostot lokale, të cilat janë përllogaritur të jenë rreth 5 milion Euro.

Ky projekt përforcon lidhjet interkonjektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën Jugore të Shqipërisë ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të prodhimit të energjisë elektrike, dhe si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian si dhe krijon mundësi të mira për lidhje nëpërmjet kabllit nënujor me Italinë.

Projekti përfshin:

- Ndërtimi i një linje të re transmetimi 400 kV me një qark, për të implementuar një lidhje bi-nacionale mes Shqipërisë dhe Maqedonisë dhe për të përforcuar lidhjen ekzistuese të transmetimit 220 kV të tej ngarkuar dhe të vjetër midis Elbasanit dhe Fier. Traseja e Linjës Elbasan-Bitola do të ketë një gjatësi përafërsisht 56 km ndërsa linja Elbasan – Fier përafërsisht 74 km.
- Ndërtimin e nënstacionit të ri Elbasan 3 dhe përforcimi dhe zgjerimi i nënstacionit ekzistues të Fierit. Nënstacioni i ri Elbasan 3 do të zgjerojë nënstacionin ekzistues 400/220 kV Elbasan 2, me një impiant në nivelin 400 kV për të lidhur linjat Tiranë 2, Zemblak, Fier dhe Maqedoni si dhe instalimin e një shunt reaktori.

Gjithashtu nënstacioni Fier do të zgjerohet dhe pajiset me transformatorë 400/220 kV dhe një impiant në nivelin 400 kV për të lejuar lidhjen e 400 kV drejt Elbasanit 3.



Gjurma e linjës 400 kV të interkoneksionit




Diagrama njëfazore, linja 400 kV Elbasan – Fier

Zbatimi i projektit, do të bëhet i mundur në 2 Lote: Loti 1-Linjat/OHL dhe Loti 2 -Nënstationet. Shërbimi i konsulencës nga kompania Fichtner GmbH & Co KG, do të mbulojë implementimin e të dy Loteve.

Pas përfundimit të Procedurës së tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve / kompanive që do të bëjnë implementimin e projektit (Fazë e cila është parashikur të përfundoj brenda vitit 2020), në vitin 2021 parashikohet bërja efektive e kontratave të zbatimi për të dy Lotet (pagesat e avancës në vlerë sipas termave të pagesës), si dhe pagesat respektive për shërbimin e konsulencës e cila do të hyjë në Fazën e implementimit.

Parashikohet që një vlerë prej 16,224,006 Euro të disbursohet gjatë vitit 2020 për këtë projekt.

## VII.2 Investimet me fondet e OST

Përveç investimeve për projektet madhore të planifikuara për t'u mbuluar nëpërmjet kredive me institucionet financiare ndërkombëtare, OST ka planifikuar për vitin 2021 investime me fondet e veta, për rehabilitimin dhe fuqizimin e sistemit të transmetimit. Në vijim, projektet më të rëndësishme:

### ✓ *Fuqizimi i linjës 110 kV Librazhd-Përrenjas*

Linja 110 kV Librazhd-Përrenjas, me një gjatësi prej 27 km, është pjesë e traktit 110 kV Elbasan1-Korçë i cili shtrihet përgjatë rajonit juglindor të vendit. Ky rajon paraqet një zonë me potencial të lartë për zhvillimin e centraleve hidrogjeneruese të energjisë elektrike, reflektuar kjo dhe në numrin relativisht të madh të këtyre burimeve të lidhura apo të parashikuara për t'u lidhur në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes në këtë zonë.

Linja ekzistuese është me përcjellës AC-120 mm<sup>2</sup>, e ndërtuara në vitet 1966-1968. Kapaciteti transmetues i saj prej 73 MVA është i ulët, dhe nisur nga periudha shumë e gjatë e shfrytëzimit dhe shkallës së amortizimit, praktikisht linja nuk mund të ngarkohet në vlerën e lejuar termike të përcjellësit, por ngarkimi duhet të kufizohet në shkallën 80% të kapacitetit termik. Si rrjedhim, kjo e kufizon transmetimin e energjisë elektrike, sidomos në periudhat me gjenerim të lartë dhe ngarkesë të ulët (orët e natës), me qëllim shmangien e mbingarkimeve apo vlerave të palejuara të tensioneve në nyjet 110 kV.

Nisur nga pasojat negative të deritanishme dhe mundësia e rritjes së tyre në një të ardhme të afërt për shkak të kërkesave për pikë lidhje nga burimet gjeneruese në këtë zonë, lind nevoja e parashikimit të ndërhyrjeve të nevojshme për fuqizimin e kësaj linje 110 kV. Për këtë arsye u miratua në Këshillin Teknik fuqizimi i kësaj linje si pjesë e traktit 110 kV Elbasan-Korçë nëpërmjet ndërtimit të një linje të re 110 kV me shtyllëzim për linjë me dy qarqe dhe instalim të një qarku si fazë e parë. Linja 110 kV Librazhd-Përrenjas, rreth 27 km, do të realizohet me përcjellës ACSR 240/40 mm<sup>2</sup>.


### ✓ *Rikonstruksioni i linjave 110 kV Cërrik – Kajan – Kuçovë – Jagodinë.*

Linjat e këtij trakti i përkasin zonës qendrore me një fluks të madh të energjisë elektrike që transmetohet për shkak të ngarkesës. Për të evituar mbingarkimin e linjave dhe siguruar furnizimin e konsumatorëve, nga ana e operimit, ky trakt mbahet i hapur në Marinëz (Jagodinë) ose Kuçovë. Hapja e traktit në njërin nga skajet e mbingarkon skajin tjetër mbi kufirin e lejuar termik të përcjellësit.

Kjo tregon se për një zgjidhje përfundimtare të traktit Elbasan – Fier është i nevojshëm fuqizimi i të gjithë traktit deri në Fier.



Në figurën më poshtë jepet paraqitja skematike e segmenteve që do të rikonstruktohet, përfshirë edhe pjesën me shtylla me dy qarqe për linjën 110 kV Fier – Marinëz (Jagodinë) e cila parashikohet në të ardhmen.



- ✓ ***Ndërtimi i linjës së re me dy qarqe, 30 km Burrel-Bulqizë dhe 2 trakte linje në këto nënstacione.***


Zona verilindore përfshin një hapësirë relativisht të madhe, ku vitet e fundit janë ndërtuar një numër i madh HEC-esh lokale. Kjo zonë ka një potencial hidrik të madh. Në të gjithë rrjetin 110 kV të rajonit verilindor është lidhur një fuqi gjeneruese e përgjithshme prej 106 MW, ndërkohë që edhe 66.8 MW të tjerë janë lidhur në rrjetin shpërndarës të kësaj zone.

Kjo zonë përshkohet nga një linjë unazore 110 kV tepër e gjatë, ku në pjesën më të madhe të segmenteve me përcjellës AC 95 mm<sup>2</sup>, i ndërtuar në vitet 1967-1970. Ky rrjet unazor nuk e plotëson kriterin e sigurisë N-1 dhe mbingarkimet që shfaqen në rastin e hapjes së segmenteve ekstreme të unazës janë tepër të mëdha, duke shkaktuar thyerjen e nivelit të tensionit deri në dalje nga puna të të gjithë rrjetit 110 kV të rajonit.

Kushtet e vështira atmosferike të kësaj zone, gjendja konstruktive tejet e amortizuar e linjave të këtij rajoni dhe kapaciteti i ulët çojnë në kufizimin e gjenerimit, deri në ndërprerjen e tij, dhe të furnizimit të konsumatorëve. Për sa më sipër, operimi i këtij rajoni realizohet me nivel të lartë të tensionit në disa nyje, me humbje të energjise elektrike dhe kushte teknike jo optimale të operimit të burimeve gjeneruese.

Për përmirësimin e situatës në këtë zonë parashikohet ndërtimi i një linje të re 110 kV me dy qarqe Burrel – Bulqizë, me një gjatësi rreth 30 km, me përcjellës ACSR 240/40 mm<sup>2</sup> dhe zgjerimi i anës 110 kV me nga një trakt linje 110 kV në nënstacionet përkatëse.

Në figurën më poshtë jepet skema njëfazore e linjës me dy qarqe, ku janë paraqitur burimet ekzistues dhe ato të mundshme që do të lidhen në këtë segment.




✓ ***Ndërtimi i linjës 110 kV Fier-Lushnje rreth 30 km.***

Rajoni i Fierit shtrihet pranë një rajoni fushor me popullsi të dendur dhe konsiderohet si një nga zonat me konsum relativisht të lartë të energjisë elektrike. Linja Fier – Lushnje është një segment i traktit 110 kV Rrashbull – Fier, një trakt me një fluks të lartë të energjisë elektrike. Problemi i mbingarkimit të linjavë në traktin 110 kV Rrashbull – Fier është përmirësuar mjaft me rehabilitimin e segmentit 110 kV Rrashbull – Kavajë, me përcjellës ACSR240/40 mm<sup>2</sup>. Duke qënë një trakt me ngarkesë të konsiderueshme, segmenti ekzistues 110 kV Fier – Lushnje, me përcjellës AC-120 mm<sup>2</sup>, i ndërtuar ne vitin 1968 dhe i amortizuar, që nuk mund të shfrytëzohet me kapacitetin e plotë të lejuar të tij, pengon transmetimin e energjisë elektrike, dhe për këtë arsye gjatë procesit të operimit trakti mbahet i hapur në Lushnje ose Kavajë për të evituar mbingarkimin e linjës.

Për të bërë të mundur shfrytëzimin e kapacitetit të plotë të pjesës së traktit të rehabilituar dhe rritjes së sigurisë së transmetimit dhe furnizimit me energji elektrike është e nevojshme fuqizimi edhe i këtij segmenti të mbetur.

Është parashikuar ndërtimi i linjës 110 kV Fier-Lushnje me gjatësi rreth 30 km, si në figurën më poshtë.





✓ ***Ndertimi i 2 linjave 110 kV Elbasan - Cërrik, 10 km secila.***


Dy linjat ekzistuese 110 kV Elbasan - Cërrik, të ndërtuara në vitin 1957, me përcjellës AC-120 mm<sup>2</sup>, janë mjaft të amortizuara dhe rrjedhimisht me kapacitet të ulët transmetimi. Në këto linja janë lidhur konsumatorë të rëndësishëm të energjisë elektrike, si dy Uzinat e Ferrokromit me kapacitet aktualisht rreth 62 MVA dhe në perspektivë 104 MVA, dhe me proces teknologjik që kërkojnë mosndërprerje të energjisë elektrike (për shkak të furrave me hark që ato kanë). Përgjithësisht linjat janë tepër të ngarkuara dhe humbjet e energjisë elektrike në to janë relativisht të larta.

Në rastet e daljes nga puna të njëres prej linjave, kemi mbingarkim të linjës tjetër duke mos plotësuar kështu kriterin e sigurisë statike N-1.

Rikonstruksioni i këtyre linjave 110 kV do i shërbejë edhe rritjes së sigurisë së operimit të HEC Banjë dhe burimeve të tjerë të parashikuar në zonë.

Rikonstruksioni i linjave parashikon ndërtimin e të dy linjave 110 kV Elbasan – Cërrik, me përcjellës ACSR 240/40 mm<sup>2</sup>, rreth 10 km secila.

Në figurën më poshtë jepet paraqitja skematike e ndërtimit të këtyre linjave.



✓ ***Blerje Transformatori 63 MVA , 220/20 kV per N/St e Tirana 1.***

Më datë 27.12.2019 në N/Stacionin Tirana1 ka ndodhur stakimi i TR-3 (63 MVA, 220/20 kV) nga veprimi i mbrojtjes diferenciale dhe gazore. Pas kryerjes së inspektimit dhe matjeve nga specialistët e SIMPP, u vlerësua se transformatori i fuqisë TR-3, 63 MVA 220/20 kV, ka pësuar dëmtimin e pështjellës sekondare (20 kV në fazën B). Në këto kushte transformatori nuk mund të vihet në operim. Nga analiza teknike është dalë në konkluzionin se shkakun e dëmtimit të transformatorit TR-3 janë komutimet e shpeshta si pasojë e lidhjeve të shkurtra që shfaqen në linjat 20 kV që dalin nga zbarrat e këtij transformatori. Këto kanë dëmtuar bobinën e fazës B në anën 20 kV të TR-3 në N/Stacionin Tirana1.

Për normalizimin e skemës në N/Stacionin Tirana1 është e nevojshme të kryhet zëvendësimi i TR-3 220/20 kV, 63 MVA me një transformator të ri.

✓ *Upgrade dhe mirembajtje e sistemit qendror SCADA/EMS “Network Manager”.*

Platforma Network Manager ofron të gjithë funksionalitet e SCADA/EMS (Supervisory Control and Data Acquisition / Energy Management System) duke mundësuar një operim të sigurtë dhe eficient të sistemit. Ky sistem është implementuar në vitin 2011 dhe është në operim të vazhdueshëm. Si pasojë e zgjerimit të rrjetit të Transmetimit, si pasojë e përditësimit të standarteve që OST duhet të zbatonte në kuadër të operimit nëpërmjet sistemit SCADA/EMS si dhe bazuar në zhvillimet dhe standartet teknologjike është shumë e nevojshme përditësimi i këtij sistemi. OST sh.a., si anëtarë me të drejta të plota të ENTSO-E, duhet të përmbushë të gjitha standartet që vijnë nga kjo organizatë. Theksojmë që përditësimi i Network Manager është shumë i nevojshëm pasi nga ana operacionale sistemi ka mbi 8 vite në operim dhe deshtimet nga ana Hardware apo Software mund të jenë kritike. Sistemi i Transmetimit gjatë këtyre viteve ka pësuar zgjerime dhe aplikon funksionalitete të reja të cilat duhet të implementohen në sistemin SCADA/EMS nëpërmjet këtij Përditësimi. Krahas domosdoshmërisë nga ana operacionale, përditësimi i Network Manager është i domosdoshëm pasi nuk po përmbushen të gjitha standartet nga ENTSO-E.

Krahas përditësimit, për mbajtjen me efikasitet të kësaj platforme është e nevojshme të kemi një mirembajtje të avancuar. Sistemi SCADA/EMS është një platforme e shpërndarë që mblodh të dhëna nga objektet dhe i shfaq të përpunuara në QDS. Gjithashtu mbi nivelin SCADA ngrihen disa aplikacione, ndër të cilat janë LFC (Load Frequency Control) dhe EMS (Energy Management System). SCADA/EMS përveç faktit që është një sistem që duhet të jetë aktiv 24x7 është gjithashtu i ndërlidhur me OST-te e tjera për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale. Problemet e këtij sistemi mund të jenë shumë kritike nga ana e operimit.

Kostot kapitale të OST sh.a. sipas metodologjisë për vitin 2021 duhet të mbulojnë:

- Detyrimet e vitit 2021 të principalit dhe interesit për fondet e huazuara sipas skeduleve të ripagesës së huave afatgjata.
- Investimet me fondet që OST sh.a. gjeneron nga aktiviteti të përfshira në Programin e Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2021.

$$C_{\text{kapital}} = R + D$$

**R** Kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve  
**D** Amortizimi i aseteve fikse dhe amortizimi i aseteve të tjera

$$R = B * WACC$$

**B** Aseti Bazë i Rregulluar në fillim të vitit bazë të ciklit të vlerësimit të tarifave  
**WACC** Norma e lejueshme e kthimit të Asetit Bazë të Rregulluar.

Llogaritja e Asetit Bazë të Rregulluar (**B**) në fillim të vitit bazë 2021 (Vlera në fund të vitit 2020) është kryer duke llogaritur kapitalizimin e të gjitha investimeve në proces deri në 31.12.2020.

Në llogaritjen e amortizimit të vitit 2021, është mbajtur parasysh fakti që shtesat e vitit 2020 kontabilizohen pergjatë gjithë vitit dhe janë amortizuar për mesatarisht 6 muaj duke marrë në konsideratë kohën në të cilën kapitalizohen.

Për vitin 2021 amortizimi i parashikuar pritet të jetë rreth 2,564 milion lekë ndërsa Aseti Bazë i Rregulluar (RAB) në fillim të vitit 2021 është rreth 47,944 milion lekë.

1	Software dhe licenca	205/208	649,408,191	151,733,824	303,467,649	345,940,542
2	Toka	211	2,225,061,155	10,610,000	21,250,167	2,203,301,000
3	Ndertesa	212	2,524,053,610	72,918,926	145,365,210	2,378,688,400
4	Instalime, makineri dhe Pajisje të tjera	213	45,772,293,159	2,152,885,157	4,090,470,003	41,481,822,076
5	Mjete transporti	215	404,682,520	51,854,715	103,709,430	300,973,090
6	Mobiliari, pajisje zyre, pajisje informatike	218	728,963,788	96,838,022	193,676,045	535,287,742

Sipas metodologjisë norma e lejueshme e kthimit për Asetin Bazë të Rregulluar është:

Norma e lejuar e kthimit mbi Asetin Bazë të Rregulluar është mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit para taksave, e llogaritur si vijon:

$$WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)$$

$$ES + DS = 1$$

Ku:

<b>ES</b>	Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB
<b>T</b>	Norma e taksës së korporatës (Tatim-fitimi)
<b>ARoE</b>	Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse
<b>DS</b>	Objektivi për raportin e borxhit në RAB
<b>CoD</b>	Kosto e borxhit

- ARoE -** *Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazen e nevojës së OST-se për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe shërbimin e borxhit duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe përdorimit të fondeve në vitin bazë.*
- CoD -** *Kosto e borxhit – norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë është përcaktuar si shuma e pagesave të interesit mbi borxhin afatgjatë gjatë vitit baze, pjesëtuar me principalin total mbi borxhin afatgjatë (shuma totale e marrë borxh) në fillim të vitit bazë.*

Struktura e kapitalit afatgjatë të OST sh.a. sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2019 përbëhet nga kapitali i vet 61.3% dhe borxhi afatgjatë në masën 38.7%.

Për vitin 2021, objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB është llogaritur: **ES=60.06%**

Për vitin 2021, OST sh.a. ka përdorur normen e kthimit **Aroe = 8%** në mënyrë që të mbulojë realizimin e investimeve të domosdoshme.

Për vitin 2021 norma mesatare e interesit mbi borxhin afatgjatë është llogaritur: **CoD=3.50%**

Pjesa e prapambetur e detyrimeve për kredi afatgjata deri në fund të muajit Gusht 2020, është 10,743 milionë lekë. Detyrimi për pagesën e këtyre kredive të prapambetura është e OSHEE sipas vendimit të ERE nr. 190, datë 22.12.2016.

Sipas metodologjisë:

- *Financimi afatgjatë i borxhit duhet përdorur për të financuar shpenzimet e reja kapitale për atë që është e mundur, por nuk duhet përdorur për të mbuluar kostot e operimit*

OST i përdor fondet e siguruar nga kreditë afatgjatë ekskluzivisht për investimet e reja kapitale.

Gjatë viteve të fundit OST është angazhuar kredi afatgjata për të financuar projekte më të mëdha për zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Kjo gjë ka rritur detyrimet për interes dhe principal që duhen shlyer gjatë vitit 2021 të cilat janë rreth 3,664 milion lekë.



B. Kostot operuese

$$C_{\text{operuese}} = C_{\text{matjes}} + C_{\text{mirëmbajtje}} + C_{\text{paga}} + C_{\text{humbjet}} + C_{\text{sherbimeve ndihmese}} + C_{\text{sherbime me të trete}} + C_{\text{takse}}$$

**C<sub>matjes</sub>** kosto e matjes së energjisë elektrike dhe energjisë se livruar tek klientët e sistemit të transmetimit dhe kosto e faturimit dhe likuidimeve të llogarive me përdoruesit e sistemit të transmetimit

Këto kosto lidhen me kostot e shkaktuara nga klientët, por nuk përfshin koston e matjes së humbjeve të energjisë elektrike, konsumin e energjisë elektrike për qëllime teknologjike dhe eksportin, importin dhe fluksin e tranzitit. Kostot e matjes janë të përfshira në kostot e tjera operuese të OST sh.a., respektivisht në kostot e pagave dhe mirëmbajtjes

**C<sub>mirëmbajtje</sub>** pjesë zëvendësimi, furnizime, mjete, lëndë djegëse dhe kosto të tjera mirëmbajtje;

**C<sub>paga</sub>** pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe kostot (Të ndryshme nga taksat) të lidhura me programet në përfitim të të punësuarve;

**C<sub>humbjet</sub>** kostot për mbulimin dhe prokurimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit

Në llogaritjen e tarifës së transmetimit, kosto për humbjet janë llogaritur duke u bazuar në çmimet e tregut:

$$C_{\text{humbje}} = E_{\text{humbje}} * P h$$

**E<sub>humbje</sub>** humbjet e energjisë në rrjetin e transmetimit gjatë vitit bazë

**Ph** çmimi mesatar i energjisë elektrike që do të blihet në treg për mbulimin e humbjeve gjatë vitit bazë.

**C<sub>shërb. Ndhmëse</sub>** pagesa për blerjen e shërbimeve ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit.

**C<sub>takse</sub>** Komponenti që mundëson që rregullatori të tregojë qartë pjesën e tarifës që atribuohet taksave dhe prandaj është përtej kontrollit të rregullatorit. Komponenti takse të ardhurave të synuara të OST-se për vitin baze, nuk përfshin TVSH-ne dhe tatimin mbi fitimin.



1	Mirembajtja SCADA/EMS	ALL	105,000,000
2	Vlerësim i Përgjithshëm mbi Sigurinë Kibernetike dhe kryerje e Testimeve mbi Infrastrukturën dhe platformave Teknologjike	ALL	50,000,000
3	Automjete me qira operationale "Leasing"	ALL	30,000,000
5	Shpenzime për koncesione, patenta, licensa dhe të ngjashme	ALL	20,000,000
7	Eksperte Kontabel dhe Vleresues	ALL	20,000,000
9	Mirembajtje e ambienteve të jashtme të zyrave qendrore	ALL	17,000,000
11	Sistemi i administrimit të proceseve dhe puneve në terren	ALL	16,000,000
13	Mirembajtja e pajisjeve DWDM	ALL	12,500,000
15	Sherbim Teknik me jashte, aplikime, pjesmarrje	ALL	10,000,000
17	Suport dhe mirëmbajtje për pajisjet hardware.	ALL	8,000,000
19	Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	ALL	5,000,000
21	Sherbim linje telekomunikacioni NDC HTSO-NDC OST, për një vit	ALL	3,000,000
23	Shpenzime për shërbimet bankare	ALL	2,500,000
25	Sigurime	ALL	2,400,000
27	Mirembajtja e sistemit të monitorimit të fibres optike (OPGW )	ALL	1,900,000
28	Publicitet, reklama	ALL	1,400,000
29	Sherbimi i mirembajtjes së sistemit PSSE	ALL	1,300,000
30	Mirembajtje Sistemet BMT	ALL	1,200,000
31	Te tjera	ALL	14,000,000

✓ ***Materiale të para***

Shpenzimet e materialeve përfshijnë të gjitha materialet që përdoren në mirëmbajtjen e linjave, nën-stacioneve, godinave, karburanti dhe kancelaritë. Në llogaritjen e vlerës së këtij zëri jemi nisur nga realizimet faktike disa vjecare, programin e realizimitin e pritshëm për vitin 2020 si dhe në kërkesat kryesore të Njesive, për kryerjen e aktivitetit normal të punës së tyre. Për vitin 2021 shpenzimet për materiale të para parashikohet të jenë 130 milione lekë. Në mënyrë më të detajuar, paraqiten si më poshtë:

Blerje Lëndë djegëse.	ALL	150,000,000
Blerje Kancelarie	ALL	3,000,000
Blerje materiale per Njesite Operative	ALL	77,000,000

✓ ***Prokurimi i humbjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit për vitin 2021.***

Në bazë të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit, nëpërmjet një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente.

Në këtë drejtim në vitin 2017 nëpërmjet Vendimit nr. Nr. 193, Datë 24.11.2017, u miratuan nga ERE, “Rregullat e Përkohshme për Mekanizmin Balancues”, duke kaluar nga çmimet e rregulluara në çmime tregu (referuar burses HUPLEX) dhe në fillim të vitit 2018 filloi prokurimi i humbjeve në rrjetin e transmetimit nëpërmjet një procedure konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente.

Për vitin 2021, humbjet e energjisë në rrjetin e transmetimit vlerësohen të jenë rreth 184 milione kWh. Kjo sasi energjie do të blihet me baze tregu, dhe bazuar në të dhënat e HUPX si dhe te dhenat historike per blerjen me baze tregut te energjis per mbulimin e humbjeve prej Janarit 2018 dhe ne vijim, është konsideruar çmimi mesatar vjetor prej rreth 55 €/MWh.

Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 10 milione Euro, ose rreth 1,255 milion leke.

✓ ***Prokurimi i kapacitetit rregullues dhe atij rezerve për shërbimin e balancimit për vitin 2021***

Në përputhje me Manualin e Operimit të ENTSO-E, nga ana e TSOve është i detyrueshëm garantimi i rezervave rregulluese të nevojshme për balancim si dhe zbutjen/eliminimin e incidenteve në sistemin e transmetimit.

Masa e sigurimit të tyre merr në konsideratë llogaritjet duke përdorur si variabël ngarkesën e vëndit në rastin e rezervave automatike të rivendosjes së frekuencës.

Ndërsa për përcaktimin e rezervës zëvendësuese, në funksion të risqeve operationale që shoqërojnë sigurinë e operimit të sistemit (regjime eksporti apo importi të larta), ajo përcaktohet në atë masë që të mund të sigurojë zbutjen/eliminimin e ndikimit të incidentit duke mos lejuar përhapjen e shqetësimit të krijuar drejt sistemeve fqinje të transmetimit (kriteri i mbulimit të gjeneratorit me fuqi më të madhe i angazhuar në operim).

Në lidhje me shërbimet ndihmëse të kërkuara për vitin 2021, sipas llojit të shërbimit, nga eksperiencia e deritanishme rezulton se për Sistemin Elektroenergjetik Shqiptar rezerva automatike e rivendosjes së frekuencës (aFRR) është e nevojshme për t'u siguruar për 8,760 orë në masën 70MW(+/-35MW), ndërsa ajo e rezervës terciare (mFRR) për 8,760 orë në masën 110MW. Kështu në kushtet e prokurimit të rezervës në bazë tregu duke patur parasysh implementimin e Tregut Balancues, bazuar në cmimet e rajonit kosto e rezervës është:

Kapaciteti	Kapaciteti (MW)	Cmimi (€/MWh/h)	Nr. Oreve	Vlera në €	Vlera në mln Leke
aFRR (+)	40	10,55	8760	3.696.720	458.393.280
aFRR (-)	30	11,35	8760	2.982.780	369.864.720
mFRR (+)	75	2,5	8760	1.642.500,00	203.670,000
mFRR (-)	35	4	8760	1.226.400	152.073.600
<b>Totali</b>				<b>9,548,400</b>	<b>1,184,001,600</b>

#### ✓ *Shpenzimet për ITC*

Për përcaktimin e vlerës së ITC për vitin 2021 janë marrë në konsideratë të dhënat disavjecare të pagesave për kete ze. Këto pagesa janë në proporcion të drejtë me marrëdhëniet e shkëmbimit të energjisë me shtetet e tjera. Mekanizmi tek i cili bazohet llogaritja e ITC është "PAN-EUROPEAN INTER-TSO COMPENSATION MECHANISM". Ky mekanizëm është projektuar për të kompensuar palët për shpenzimet që lidhen me humbjet që rezultojnë nga bartja e flukseve të energjisë në sistemet e tyre. Duke ndjekur trendin disavjecar të ITC si dhe parashikimin e energjise për vitin 2021 shpenzimet për CBT parashikohet të jenë rreth 250 milion lekë.

#### ✓ *Shpenzime për pjesmarrjen në organizmat rajonale*

Për vitin 2021 janë parashikuar të kryhen pagesa për anetaresimin në organizmat rajonale e europiane (ENTSO-E, MED-TSO, etj) në të cilat OST sh.a. është angazhuar e cila në vlerë pritet të shkojë rreth 100 milionë Lekë.

#### C. Të ardhurat nga Alokimi i Kapaciteteve

Në mbështetje të hapjes dhe zhvillimit të tregut të kapaciteteve në interkonjeksion, janë miratuar "Rregullat për Alokimin e Kapaciteteve në Interkonjeksione", në Nëntor të vitit 2013 si dhe rregullat për alokimin e kapaciteteve në Zyrën Rajonale të Alokimit të Kapaciteteve.

Kështu, në mbështetje të angazhimeve të dala nga Traktati i krijimit të Komunitetit të Energjisë së vëndeve të Evropës Juglindore përfshirë dhe Shqipërinë si dhe në mbështetje të obligimeve të ndërmarra në kuadër

të krijimit dhe funksionimit të zyrës rajonale të alokimit të Kapaciteteve, SEE CAO, kjo zyrë do të realizojë procedurat e ankandëve për alokimin e kapaciteteve me baza vjetore, mujore dhe ditore.

Duke konsideruar se volumi i transaksioneve të energjisë, pra edhe i kërkesës për kapacitete transmetuese në interkonjeksion, nuk është proporcional përgjatë gjithë muajve të vitit, parashikimi i të ardhurave që OST mund të sigurojë në ankandet e alokimit të kapacitetit në interkonjeksion përgjatë gjithë vitit 2020 parashikohet të jetë rreth 12 milion Euro ose 1,500 milionë lekë. Këto të ardhura do të sigurohen nga Pjesmarrësit e Tregut dhe janë të ardhura të cilat merren në konsideratë dhe zbriten nga të ardhurat e kërkuara në përlogaritjen e tarifës së kërkuar të transmetimit.

## VII. Ndarja e kostove në kapacitet dhe energji

### i. Pagesat e kapacitetit

Përdoruesit e energjisë elektrike paraqesin një ngarkesë elektrike që ndryshon në çdo cast. Rrjeti elektrik duhet të ndërtohet i tillë që të garantojë shërbimin e energjisë elektrike brenda parametrave teknike dhe të sigurisë në çdo moment të kohës. Llogaritjet për fuqizimin e rrjetit elektrik bëhen për rastin më të rëndë që është ngarkesa e pikut, pra ato varen nga ngarkesa maksimale e konsumatorëve gjatë periudhës llogaritëse dhe jo nga energjia elektrike që ata konsumojnë gjatë kësaj periudhe.

Për këtë, investimet që bëhen për fuqizimin e kapacitetit transmetues të rrjetit elektrik janë funksion i ngarkesës maksimale që paraqesin përdoruesit e këtij rrjeti.

Cdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë kapaciteti në lekë/kW/Muaj, të bazuar në ngarkesën pik gjatë periudhës 12 mujore që mbaron në muajin e faturimit.

Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të kapacitetit për vitin 2020 janë të barabarta me:

$$C_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapital}}$$

$$C_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapital}} - R_{\text{Alokimi}}$$

$R_{\text{Alokimi}}$  Janë të ardhurat nga alokimi i kapaciteteve nderkufitare të cilat për efekt të llogaritjes së Tarifave të Transmetimit nuk përfshihen në totalin e të ardhurave të kërkuara.

Gjatë 3 viteve të fundit, shuma e kapacitetit total mujor të bazuar në ngarkesën pikë gjatë periudhës 12 mujore për secilin klient të lidhur në rrjetin e transmetimit ka qënë si më poshtë:



Operatori i Sistemit të Transmetimit

Viti 2018				
Nr.	Subjekti	Ora	Data	Kapaciteti (kW)
1	DEVOLLIHPP-T1/751	16:00	01-04-18	2,662
2	EL220-L220KURUM/338	21:00	03-03-18	54,944
3	F.Arrez-T3/653	18:00	23/05/2018	2,015
4	FERRO KROM-F1(10kV)/342	8:00	20/01/2018	7,168
5	FERRO KROM-F2(10kV)/228	10:00	29/03/2018	7,259
6	FERRO KROM-F3(10kV)/343	19:00	17/4/2018	11,043
7	FERRO KROM-F4(10kV)/229	7:00	01-01-18	10,197
8	FUSHE KRUIJE 220kV-T2/058	10:00	23/04/2018	22,433
9	HEC Ashta1-T1/035	4:00	20/03/2018	114
10	HEC ASHTA2-T1/213	2:00	06-04-18	114
11	HEC Banje-T1/753	15:00	06-12-18	169
12	HEC Banje-T2/755	4:00	26/06/2018	168
13	HEC Fang-T1/544	21:00	23/03/2018	146
14	HEC Fang-T2/757	6:00	24/05/2018	84
15	HEC Peshqesh-T1/633	2:00	14/01/2018	155
16	N/ST 220/6,3COLACENT-T1/043	15:00	18/07/2018	5,848
17	N/ST i AES EL 110kV-T1/690	13:00	03-06-18	19,583
18	N/ST I AES EL 110kV-T2/692	15:00	03-06-18	19,990
19	N/ST i GSA EL 110kV-T1/694	12:00	23/1/2018	22,241
20	N/ST i GSA EL 110kV-T2/960	15:00	06-08-18	11,824
21	TEC Balsh-T1/598	15:00	07-06-18	8,745
22	TITAN 220kV-T1/126	23:00	02-06-18	9,534
23	TITAN 220kV-T2/127	3:00	07-02-18	9,887
<b>SHUMA E KONSUMATOREVE TE TJERE</b>				<b>226,323</b>
15	<b>OSHEE</b>	19:00	28/02/2018	1,245,020
<b>SHUMA E SISTEMIT</b>				<b>1,471,343</b>

Viti 2019				
Nr.	Subjekti	Ora	Data	Kapaciteti (kW)
1	DEVOLLIHPP-T1/751	17:00	1/5/2019	1,780
2	EL220-L220KURUM/338	03:00	4/7/2019	57,024
3	F.Arrez-T3/653	17:00	3/24/2019	2,470
4	FERRO KROM-F1(10kV)/342	23:00	4/11/2019	2
5	FERRO KROM-F2(10kV)/228	09:00	2/1/2019	572
6	FERRO KROM-F3(10kV)/343	01:00	7/17/2019	10,769
7	FERRO KROM-F4(10kV)/229	12:00	5/19/2019	9,604
8	FUSHE KRUJE 220kV-T2/058	09:00	3/22/2019	22,545
9	HEC Ashta1-T1/020	05:00	9/24/2019	80
10	HEC ASHTA2-T1/213	17:00	4/5/2019	80
11	HEC Banje-T1/753	13:00	9/19/2019	15
12	HEC Banje-T2/755	17:00	8/11/2019	135
13	HEC Fang-T1/544	07:00	1/8/2019	162
14	HEC Fang-T2/757	23:00	1/16/2019	169
15	HEC Peshqesh-T1/633	03:00	1/17/2019	147
16	N/ST 220/6,3COLACENT-T1/043	11:00	1/8/2019	5,884
17	N/ST i AES EL 110kV-T1/690	08:00	6/13/2019	20,080
18	N/ST I AES EL 110kV-T2/692	11:00	5/5/2019	20,412
19	N/ST i GSA EL 110kV-T1/694	03:00	8/30/2019	12,933
20	N/ST i GSA EL 110kV-T2/960			
21	TEC Balsh-T1/598	14:00	8/20/2019	9,481
22	TITAN 220kV-T1/126	09:00	7/13/2019	9,773
23	TITAN 220kV-T2/127	20:00	10/4/2019	9,840
<b>SHUMA E KONSUMATOREVE TE TJERE</b>				<b>193,957</b>
15	<b>OSHEE</b>	ora 18.00	1/9/2019	1,332,629
<b>SHUMA E SISTEMIT</b>				<b>1,526,586</b>



Viti 2020				
Nr.	Subjekti	Ora	Data	Kapaciteti (kW)
1	EL220-L220KURUM/338	08:00:00	6/18/2020	58,120
2	F.Arrez-T3/653	19:00:00	1/23/2020	2,473
3	FERRO KROM-F1(10kV)/342	09:00:00	1/29/2020	0
4	FERRO KROM-F2(10kV)/228	10:00:00	1/20/2020	465
5	FERRO KROM-F3(10kV)/343	20:00:00	7/19/2020	11,222
6	FERRO KROM-F4(10kV)/229	04:00:00	7/17/2020	0
7	FUSHE KRUIJE 220kV-T2/058	08:00:00	6/11/2020	21,823
8	HEC Ashta1-T1/020	18:00:00	1/20/2020	58
9	HEC ASHTA2-T1/213	18:00:00	1/20/2020	51
10	HEC Banje-T1/753	23:00:00	6/11/2020	125
11	HEC Banje-T2/755	11:00:00	6/11/2020	127
12	HEC Fang-T1/544	07:00:00	1/10/2020	155
13	HEC Fang-T2/757	16:00:00	3/24/2020	124
14	Hec Moglice 220kv-T1/182	10:00	2/7/2020	230
15	Hec Moglice 220kv-T2/184	17:00:00	2/6/2020	169
16	Hec Moglice 220kv-T3/751	12:00:00	1/24/2020	736
17	HEC Peshqesh-T1/633	23:00	1/21/2020	135
18	Lajthiza T1/742	20:00:00	2/11/2020	817
19	N/ST 220/6,3COLACENT-T1/336	23:00:00	3/2/2020	5,760
20	N/ST i AES EL 110kV-T1/690	10:00:00	6/3/2020	9,824
21	N/ST I AES EL 110kV-T2/692	12:00:00	7/13/2020	10,952
22	N/ST i GSA EL 110kV-T1/694	10:00:00	7/8/2020	12,569
23	N/ST i GSA EL 110kV-T2/960			
24	TEC Balsh-T1/598	02:00:00	2/7/2020	142
25	TITAN 220kV-T1/338	18:00:00	2/22/2020	10,183
26	TITAN 220kV-T2/339	20:00:00	8/17/2020	9,848
<b>SHUMA E KONSUMATOREVE TE TJERE</b>				<b>156,108</b>
15	<b>OSHEE</b>	19:00	1/8/2020	1,322,924
<b>SHUMA E SISTEMIT</b>				<b>1,479,032</b>

Duke analizuar situatën elektroenergjitike për vitin 2021, OST sh.a. vlerëson se shuma e kapaciteteve totale të Konsumatoreve të Kualifikuar + OSHEE do të jetë e barabartë me 1,450,000 kW.

Pagesa e kapacitetit në lekë për kW në muaj është e barabartë me:

$$P_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapacitet}} \div L$$

*L* - shuma e kapacitetit total mujor e treguar në faturat e transmetimit, gjatë 12 muajve të vitit baze

ii. Pagesat e energjisë

Çdo klient i sistemit të transmetimit duhet të paguajë një pagesë për energjinë në lekë/kWh, bazuar në sasinë e kWh të livruar nga sistemi i transmetimit tek klienti i sistemit të transmetimit gjatë atij muaji. Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të energjisë në vitin bazë janë të barabarta me:

$$C_{\text{energji}} = C_{\text{matjes}} + C_{\text{mirëmbajtje}} + C_{\text{paga}} + C_{\text{humbje}} + C_{\text{tek}} + C_{\text{jashteburimore}} + C_{\text{taksa}}$$

Pagesa e energjisë në lekë për kWh është e barabartë me:

$$P_{\text{energji}} = C_{\text{energji}} / E$$

*E* - energjia totale në kWh që do tregohet në faturat e klientit të sistemit të transmetimit gjatë vitit baze

Pagesat e energjisë përfshijnë edhe kostot e nevojshme për matjen, faturimin dhe kostot e likuidimit të OST-se për të siguruar shërbimin e matjes së energjisë për klientët e lidhur në rrjetin e transmetimit.

Në këtë mënyre, OST sh.a. nuk ka kërkuar një tarifë të vecante për matjen e energjisë ashtu sic parashikohet në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit ku secili prej klientëve të sistemit të transmetimit duhet të paguajë: **Pagesa mujore fikse në lekë për pikë livrimi është e barabartë me:**

$$P_{\text{mujore}} = C_{\text{matjes}} / N$$

iii. Llogaritja e tarifës mesatare të transmetimit

Në çdo vit të ciklit të shqyrtimit të tarifës, tarifa mesatare e transmetimit është e barabartë me:

$$P_{\text{mesatare}} = (C_{\text{kapacitetit}} + C_{\text{energjisë}}) / E$$

*P mesatare* - tarifa mesatare e transmetimit

Duke u bazuar ne Realizimin faktik te vitit 2019 si dhe parashikimeve te tregueseve ekonomiko-financiar për vitet 2020 dhe 2021, si dhe duke u mbështetur ne metodologjine e tarifave, OST sh.a. ka bere vleresimet sipas tabelës ne vijim.

Metodologjia e llogaritjes se tarifave te transmetimit			Viti 2019- 2020		Viti 2021
Pershkrimi	Njesia		Tarifa e miratuar	Tarifa sipas metodologjise	Tarifa sipas metodologjise
Nivel I synuar I te ardhurave (I+II+III)	Million Leke				
$C = C_{\text{kapital}} + C_{\text{operuese}}$ - Te ardhurat nga abkimi i kapaciteteve			10,632	12,694	9,448
<b>I. C kapital= R+D</b>			6,842	8,905	5,978
<b>1 Kthimi mbi kapitalin (R = B*wacc)</b>	Million Leke		1,493	3,555	3,414
<b>a. B (Baza e rregulluar e asetëve)</b>	***		49,322	49,322	47,944
<b>b. WACC = [ES * ARoE/ (1-T)] + (DS * CoD)</b>	%		3.03%	7.21%	7.12%
ES - Objektivi per raportin e kapitalit te vet ne RAB	***		61.3%	61.3%	61.3%
T - Norma e takses se korporates	***		15%	15%	15%
ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	***		4.2%	8.0%	8.0%
DS - Objektivi per raportin e borxhit ne RAB	***		38.7%	38.7%	38.7%
CoD - Kosto e borxhit	***		0.0%	3.7%	3.5%
<b>2 Amortizimi i vitit (D)</b>	Million Leke		5,349	5,349	2,564
<b>II. C operuese</b>	***		6,869	6,869	4,970
1 Personel	***		2,472	2,472	1,450
2 Sherbime administrative e te tjera	***		1,220	1,220	580
3 Materiale të para	***		224	224	135
4 Blerja e sherbimeve ndihmese	***		322	322	1,184
5 Blerja e humbjeve	***		2,055	2,055	1,265
6 Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	***		398	398	250
7 Pagesë për organizmat rajonale e europianë	***		170	170	100
8 Taksa	***		8	8	6
<b>III. Te ardhurat nga alokimi i kapaciteteve</b>	***		(3,080)	(3,080)	(1,500)
<b>E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjere)</b>	GWh		14,124	14,124	7,216
<b>Tarifa mesatare e transmetimit</b>	Lek/kWh		0.75	0.90	1.31
<b>1</b>	$P_{\text{kapacitet}} = C_{\text{kapital}} / L$	Leke/kW/muaj	210.1	325.2	252.3
	C kapital - Te ardhurat nga Abkimi	Million leke	3,763	5,825	4,478
	L - shuma e kapacitetit total mujor	kW	1,492,538	1,492,538	1,479,032
<b>2</b>	$P_{\text{energjia}} = C_{\text{operuese}} / E$	Leke/kWh	0.49	0.49	0.69
	C operuese	Million leke	6,869	6,869	4,970
	E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjere)	GWh	14,124	14,124	7,216
<b>3</b>	$P_{\text{mesatare}} (\text{Tarifa mesatare e transmetimit}) = (C_{\text{kapacitetit}} + C_{\text{energjia}}) / E$	Lek/kWh	0.75	0.90	1.31

\*mungesa ne te ardhurat e kerkuara nga tarifa per vitet 2019-2020 – 2,062 milione leke


Ky vleresim parashikon përmbushjen e të gjitha detyrimeve të OST sh.a. përgjatë vitit 2021, duke përfshirë pagesën e detyrimeve për kredi të cilat aktualisht janë detyrim i OSHEE për t'u paguar, referuar vendimeve të ERE nr. 52, date 6.4.2017 dhe nr.190, datë 22.12.2016 të cilët përcaktojnë se:

“OSHEE sh.a, përveç shlyerjes së detyrimeve korente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a dhe OST sh.a nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a dhe KESH sh.a.”;

Ju bëjmë me dije se për vitin 2021 OST duhet të paguajë rreth 2,954 milion lekë në bazë të marrëveshjeve për ripagimin e kredive me Ministrinë e Financave dhe KESH.

Për të iluastuar në mënyrë më të qartë domosdoshmërinë për tarifën e nevojshme të OST sh.a., po paraqesim në menyre grafike mbulimin e kostove të parashikuara për vitin 2021, duke bërë një krahasim me tarifën egzistuese.

### Mbulimi Kostove 2021 (tarifa aktuale)




Siç vërehet nga grafiku, tarifa aktuale e transmetimit (0.75 lekë/kWh), do të krijojë një pamundesi për realizimin e plotë të investimeve si dhe për shlyerjen e detyrimeve korrente për huatë afatgjata.

Për kryerjen e aktivitetit normal të OST sh.a., për të mundësuar mbulimin e plotë me fonde të shpenzimeve, investimeve dhe shërbimin e borxhit, është mjaft e rëndësishme miratimi i tarifës në nivelin e kërkuar prej **1.31 lekë/kWh**.

Për të ilustruar këtë fakt, në grafikun e mëposhtëm tregohet efekti i tarifës në Cash Flow

Efekt i Tarifës në Mbulimin e Aktivitetit të OST sh.a.



***Duam të theksojmë se, me hyrjen në fuqi të “Rregullave Të Tregut Shqiptar Të Balancimit Të Energjisë Elektrike”, sipas vendimit Nr. 106, datë 02.07.2020 të Entit Rregullator të Energjisë, kostot e sigurimit të shërbimeve ndihmëse, parashikohet të kenë një rritje të konsiderueshme duke kapur vlerën rreth 1,2 miliardë Lekë.***

***Ju lutemi marrjen në konsideratë të kësaj rritje, me efekt shumë të madh, në miratimin e tarifës së transmetimit për vitin 2021.***

OST mbetet në dispozicionin Tuaj për çdo informacion shtesë që mund të kërkohet nga ana Juaj në funksion të përcaktimit të tarifave të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020.

Ju faleminderit,

**ADMINISTRATORI I OST sh.a.**

*Skërdi Drenova*  
**Skërdi Drenova**

